



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1139/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të mungesës të votave, për Rivotim të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datë 17.12.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të mungesës të votave, për Rivotim të Zgjedhjeve Lokale në Komunën e Istogut të datës 17.12.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën me datë 18.12.2017, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë dega në Istog, në të cilën pretendon se pas shpalljes së rezultatit preliminar nga ana e KQZ-së në ditën e votimit, në Qendrat e Votimit QVnr. 0622C/01R, 0623C/02D, duke u bazuar nga të dhënat e vëzhguesve nga radhët e subjektit politik AAK rezultati i zgjedhor është si vijon : në Qendrën e Votimit QV nr. 0622C/01R figurojnë 266 vota për subjektin politik LDK, ndërsa 318 vota për subjektin politik AAK dhe në Qendrën e Votimit QVnr. 0623C/02D figurojnë 194 vota për subjektin politik LDK, ndërsa 223 vota për subjektin politik AAK. KQZ-ja, një ditë pas shpalljes së rezultateve zgjedhore ka deklaruar ndryshimin e rezultatit në këto Qendra të Votimit për shkak të gabimeve gjatë raportit. Prandaj, nga PZAP-i ka kërkuar që për shkak të mospërputhjes së rezultateve të bëhet rinumërimi i fletvotimeve në kutit e votimit në Qendrat e Votimit të lartëcekura.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara në ankesë përkitazi me parregullsit në Qendrat e Votimit QVnr. 0622C/01R, 0623C/02D, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesës. Hudhja e ankesës së subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë dega në Istog, nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.1139/2017 më datën 19.12.2017

**Kryesuese e Panelit
Gyltane Sylejmani**



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.